

4.5 RUAJTJA E PYETËSORËVE

Pyetjet për kërkim mund t'i ruani dhe ato më vonë t'i përdorni në formën e një pyetëtori.

Procedura

1. Shënoni pyetjet për kërkim (shih kap. 4.1–4.3).
2. Klikoni butonin **Ruaj pyetëtorin**.
Hapet dritarja **Pyetëtori**.
3. Shënoni emrin me të cilin dëshironi ta ruani pyetëtorin.
4. Klikoni butonin **Në rregull**.

Pyetëtori do të shtohet në dritaren për kërkim të "Pyetëtorët" dhe në shfletues në nëndritaren **Pyetëtorët**.

Procedura e riemërtimit dhe fshirjes së pyetësorëve është e përshkruar në manualin *COBISS3Udhëzimet themelore*.

Pyetëtorin e ruajtur mund ta përdorni më vonë për kërkim.

Procedura

1. Te "Pyetëtorët" përzgjidhni pyetëtorin përkatës.
Pyetjet për kërkim nga pyetëtorët transferohen në fushat përkatëse të dritares për kërkim.
2. Klikoni butonin **Gjej**.
Programi fillon kërkimin në bazën e përzgjedhur të të dhënave. Më pas shfaqen rezultatet e kërkimit, të cilat korrespondojnë me pyetjet për kërkim të ruajtur në pyetëtor.

Mundësitë...

Pyetëtorin mund ta aktivizoni edhe në shfletues. Në nëndritaren **Pyetëtorët** mund të përzgjidhni metodën **Pyetëtorët / Gjej** ose klikoni dy herë shenjën grafike ose emrin e pyetëtorit. Hapet dritarja për kërkim, në të cilën tashmë janë shfaqur rezultatet e kërkimit në bazën lokale të të dhënave. Mundësia e kërkimit të ri nuk ekziston.